

L I G J
Nr.8024, datë 2.11.1995

**PËR MIRATIMIN ME DISA SHTESA E NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1254, DATË
19.10.1995 “PËR KOMPENSIMIN E ISH-PRONARËVE TË TROJEVE TË ZËNA, TË
TOKËS BUJQËSORE DHE JOBUJQËSORE, ME TROJE NË ZONAT TURISTIKE DHE NË
QENDRAT E BANUARA”**

Në mbështetje të neneve 16 e 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet me disa shtesa e ndryshime dekreti nr.1254, datë 19.10.1995 “Për kompensimin e ish-pronarëve të tokës bujqësore, jobujqësore dhe të trojeve të zëna, me troje në zonat turistike dhe në qendrat e banuara” me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 1 formulohet:

“Të kompensohen me troje në zonat turistike dhe në qendrat e banuara ish-pronarët e trojeve të zëna, e tokës bujqësore dhe jobujqësore”.

Neni 2 formulohet:

Në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, me ndryshimet përkatëse, shtohen neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre, pronat në formën e tokës bujqësore dhe jobujqësore të cilat nuk janë trajtuar nga ligji nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, kur këto prona janë tjetërsuar në truall në rastin e miratimit të vijave të reja kufizuese të qendrave të banuara, si dhe të zonave me interes për zhvillimin e turizmit, dhe kur ish-pronarët apo trashëgimtarët e tyre nuk janë kompensuar, duke i trajtuar si troje dhe duke përcaktuar masën e kthimit në bazë të këtij ligji. Edhe kullotat, livadhet dhe pyjet, që ndodhen brenda vijave kufizuese të zonave me interes për zhvillimin e turizmit do të trajtohen si truall për efekt kompensimi siç u tha më lart”.

Neni 3 formulohet:

Në ligjin nr.7917, datë 13.4.1995 “Për kullotat dhe livadhet”, në nenin 4 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Kullotat dhe livadhet që ndodhen brenda vijave kufizuese të zonave me interes zhvillimi të turizmit konsiderohen troje dhe do të trajtohen në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” me ndryshimet përkatëse.

Neni 4 formulohet:

Në ligjin nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore” me ndryshimet përkatëse bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i ligjit ndryshohet si vijon: “Për kompensimin në vlerë ose me troje të ish-pronarëve të tokës bujqësore”.

2. Në nenet 3,4,5 dhe 8 (pika 1), pas fjalëve “kompensim në vlerë” shtohen fjalët “ose kompensim në natyrë me troje”.

3. Në nenin 8, pika 3 paragrafi i dytë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Vlera e tokës së dhënë në kompensim në natyrë duhet të jetë jo më e madhe se sa kompensimi përkatës në vlerë i llogaritur sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Çmimi për njësi i tokës përcaktohet përkatësisht në ligjin nr.7836, datë 22.6.1994 “Për çmimin e tokës bujqësore për efekt kompensimi” dhe në ligjin nr.7832, datë 16.6.1994 “Për çmimin e truallit që kompensohet”

- Pas nenit 4 të dekretit shtohet neni 5 me këtë përmbajtje:

Në radhën e kompensimit kanë prioritet:

1- Ish-pronarët që kanë patur tokë më afër tokës së përdorur për kompensim.

2. Ish-pronarët që kanë patur tokë më afër llojit të tokës (si vendndodhje) të përdorur për kompensim.

3. Banorët më afër tokës së përdorur për kompensim.

4. Ish-pronarët që kanë pasë disponuar më shumë se 50 ha tokë.

Sipas dëshirës së ish-pronarit, mund të kalohet nga një radhë prioriteti më i lartë në një radhë prioriteti më të ulët.

- Neni 5 i dekretit bëhet neni 6.

- Neni 6 i dekretit bëhet neni 7.

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1285, datë 16.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha